



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 483, datë 16/11/2017

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me kushtet e licencës së aktivitetit të tregtimit të gazit natyror”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Juliana	LATIFI	Kryetare
Eduard	YPI	Zv/Kryetar
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtar
Leida	MATJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.11.2017, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vlerësimi i vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Nr. 163, datë 12.10.2017 “Për fillimin e procedurave për miratimin e licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror” dhe draft-licencës përkatëse.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të informacionit në lidhje me miratimin e licencës së aktivitetit të tregtimit të gazit natyror dhe draft-licencës përkatëse:

VËREN SE:

Enti Rregullator i Energjisë, me anë të shkresës Nr. 684 prot, datë 20.10.2017, ka dërguar për marrje mendimi vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 163, datë 12.10.2017 “Për fillimin e procedurave për miratimin e licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror”.

Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 163, datë 12.10.2017 është hartuar dhe ka filluar procedurën për miratimin e licencës për aktivitetin e tregimit të gazit natyror në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, seksionit II, neni 22, 23, të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit natyror”, si dhe neni 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016.

Në draft-licencën e publikuar janë parashikuar kushtet për veprimtarinë e tregimit të gazit natyror, detyrimet e të licencuarit, kontrollin mbi performancën e veprimtarisë së licencuar, heqjen e licencës, situatat e emergjencës, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe të drejtën për apelim, bazuar në seksionin II, neni 22, 23 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentit të draft-licencës për aktivitetin e tregimit të gazit natyror, konstatohet se:

- Kushtet dhe veprimtaria e të licencuarit për tregim të gazit natyror duhet të përputhen me parashikimet e Modelit të Tregut të Gazit Natyror, i cili ende nuk është miratuar;
- Në draft – licencën e paraqitur nuk është i qartë parashikimi për tregun primar dhe tregun sekondar, të cilët janë parashikuar në nenin 4 (109) (110) dhe nenin 84(1)(2)(3)(4), të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe roli dhe funksioni i operatorit për aktivitetin e tregimit në Modelin e Tregut të Gazit Natyror;
- Në draft-licencë nuk është parashikuar afati i vlefshmërisë së licencës, sipas parashikimeve të nenit 23(1)(a) të Ligjit Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”;
- Në pikën 3.6.1 të draft-licencës nuk është parashikuar mbajtja e llogarive të ndara për gjithë aktivitetet e licencuara të operatorit, pra të përcaktohet që: *“i licencuari duhet të ketë llogari të veçanta për çdo aktivitet.*

Duke marrë në konsideratë që tregu i gazit natyror është një treg që sapo ka filluar të zhvillohet, përcaktimi i rolit, funksionit dhe kushteve të operatorit/operatorëve për zhvillimin e aktivitetit të tregimit, sipas niveleve të tregut është shumë i rëndësishëm për konkurrencën dhe eficientësinë në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f) dhe 69 e 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë:

- a) Licencimi i aktivitetit të tregtimit të kryhet pasi/ose paralelisht me miratimin e Modelit të Tregut të Gazit Natyror, të parashikuar në nenin 88 të ligjit Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, mbi bazën e të cilit do të përcaktohen nivelet e tregtimit të Gazit Natyror;
- b) Në draft – licencë duhet të përcaktohet qartë roli dhe funksioni i tregut primar dhe tregut sekondar, tregut me shumicë dhe tregut me pakicë, sipas parashikimeve të nenit 4 (109) (110) dhe nenit 84(1)(2)(3)(4), të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe roli dhe funksioni i operatorit që do të kryejë aktivitetin e tregtimit në Modelin e Tregut të Gazit Natyror
- c) Në draft-licencë duhet të përcaktohet afati i vlefshmërisë së licencës, të parashikuar në nenin 23 pika 1(a) e Ligjit Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”;
- d) Në pikën 3.6 të draft-licencës të parashikohet mbajtja e llogarive të ndara për gjithë aktivitetet e licencuara të operatorit”.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS